

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

6 - MUJORI I - VITI 2014

Programet Buxhetore:

1. Planifikim Administrim, Menaxhim
2. Trashëgimia Kulturore
3. Arti dhe Kultura

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2014**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, kreu VIII, neni 65 “Monitorimi”, të ligjit nr. 185/2013, “Për Buxhetin e vitit 2014”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” paragrafi VI “Raportet e Monitorimit” dhe Udhëzimit nr. 1/1, datë 19.02.2013 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013”, shtojcat nr. 7-11, Ministria e Kulturës, për 6 - mujorin e I të vitit 2014, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore. Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 6 - **mujorin e I të vitit 2014**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 6- mujori I 2014		Realizimi 6- mujori I 2014		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	65,283	9.99%	50,515	9.67 %	77.38%
2.	Trashëgimia Kulturore	200,385	30.69%	156,878	30.02%	78.29%
3.	Arti dhe Kultura	387,195	59.31%	315,120	60.30%	81.39%
	Totali	652,863	100.0%	522,513	100.0%	80.03%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se, buxheti është realizuar në masën 80%, ku rreth 59 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 81 %, ndjekur nga programi “Trashëgimia Kulturore shpenzimet e të cilit zënë rreth 31 % të totali dhe janë realizuar në masën 78 %, programi “Planifikim Menaxhimi” shpenzimet e të cilit zënë rreth 10 % dhe janë realizuar në masën 77 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 6- mujori I 2014		Realizimi 6- mujori I 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	439,430	67.3%	411,987	78.8%	93.8%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	118,209	18.1%	96,337	18.4%	81.5%
12	01110	231	Kapitale	95,225	14.6%	14,189	2.7	14.9%
			TOTALI	652,863	100	522,513	100	80%
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	652,863	100	522,513	100	80%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 6-mujorin e I të vitit 2014 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 94%, shpenzimet korente 82 %, dhe shpenzimet kapitale, janë realizuar në masën 15 %.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime. Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 6- mujori I 2014		Realizimi 6- mujori I 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	40,900	62.7%	34,918	69.1%	85.4%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	21,383	32.8%	15,225	30.1%	71.2%
12	01110	231	Kapitale	3,000	4.6%	372	0.7%	12.4%
			TOTALI	65,283	100	50,515	100	77.4%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 77%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 63 % të totalit dhe janë realizuar në masën 85%. Shpenzimet korrente zënë rreth 33% të totalit dhe janë realizuar në masën 71%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 5% të totalit dhe janë realizuar në masën 12%.

Mosrealizimi i fondeve në masën 22.6% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale gjithashtu pa lenë pas dhe shpenzimet korrente.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në gjashtë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 6-mujori I 2014	Buxhet/Fakt 6-mujori I 2014
A-02113	Paisje elektronike dhe elektrike		23,500	10,308	0
B-01415	Pajisje zyrash		25,500	0	0
C-02459	Akte ligjore e nenligjore		16,000	9,600	9,600
D-02461	Ristrukturim I strukturrave aktuale		15,000	15,000	15,000
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqesore		16,000	3,200	3,602
F-04248	Auditime		20,000	10,000	8,000
G-02496	Aktmarveshje		22,900	17,175	14,313
Totali			138,900	65,283	50,515

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për sa i përket produktit “Paisje elektronike dhe elektrike” për këtë 6 mujor ka patur planifikim por jo realizim.

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2014 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nënligjore” përfajson procesin e hartimit të draftit të ligjit të ri për trashëgiminë kulturore.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjes” gjatë 6 mujorit të parë janë realizuar 5 të tilla përmëndin nënshkrimi i Tradukit, Creative Europe, Salzburg, British Council dhe përmëndim si të pa nënshkruara Greqinë, Maqedoninë etj.

Në realizimin e Produktit “Auditime” gjatë këtij 6 mujori janë kryer auditime në këto institucione: DRKK Shkodër që përfshin Parkun Lezhe, Parkun Shkodër, Parku Dibër, Muzeu Skënderbeu Krujë, Parku Arkeologjik Apolloni.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti, janë kryer pagesa vendimesh gjyqësore në masën 480.000 lekë.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 6- mujori I 2014		Realizimi 6- mujori I 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	133,307	66.5%	121,522	77.5%	91.2%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	36,033	18%	29,318	18.7%	81.4%
12	01110	231	Kapitale	31,045	15.5%	6,037	3.8%	19.4%
			TOTALI	200,385	100 %	156,878	100 %	78.3 %
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	200,385	100 %	156,878	100 %	78.3 %

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 78%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 67 % të totalit dhe janë realizuar në masën 91%, shpenzimet korrente zënë rreth 18% të totalit dhe janë realizuar në masën 81% dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 16% dhe janë realizuar në masën 19%.

Mosrealizimi në masën 21.7 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë				08220
Kodi i Produktit	Emri Produktit	Shpenzimet e Produktit			
		PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 6-mujori I 2014	Buxhet/Fakt 6-mujori I 2014
A-00324	Muze Kombetare me standarte dhe sherbime te permirsuara		100,552	47,419	41,510
B-00324	Infrastrukture arkeologjike, monumentale, peizashistike ne Parqet Arkeologjike		43,462	16,429	10,750
C-00324	Objekte “monument kulture” te konservuara dhe restauruara		237,179	110,167	91,053
D-00324	Aktivitete te trashegimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara		54,441	22,451	9,791

MINISTRIA E KULTURËS

E-00324	Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale		7,966	3,918	3,774
	Totali		443,600	200,384	156,878

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar.

➤ **“Objekte "monument kulture" te konservuara dhe restauruara**

Ky produkt konsiston në monitorimin, mirmbajtjen, konsolidimin, konservimin restaurimin, mbrojtjen e objekteve Monumente Kulture.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare si dhe Parqet Arkeologjike kryejnë në mënyrë të vazhdueshme mirëmbajtjen restaurimin, konsolidimin e objekteve Monument Kulture.

DRKK - Berat, ka kryer restaurime të fasadës së banesës Irakli Xhimitikut Vallezërisë Mile Lagjja Goricë, fasadës anësore (veriore) së Drkk Berat, kalldrëmit para xhamisë mbret, murit rrethues të gurit së xhamisë mbret qëndra mesjetare, çatisë së banesës Naun Dyshnikut Lagjja Kala, banesës së Lili Simsisë, murit të Ish Banesa e Vrionasve, Banesës së Vasil Shytit, kalldrëmit lagjja Mangalem, Ndërtimi i murit të gurit midis kullave 1-2 për parandalim e hipjes në kullë lagjja kala, etj.

Mirëmbajte dhe pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët në tre lagjet e qendrës historike, në qendrën mesjetare dhe në monumentet e kultit të qytetit të Beratit si dhe i kishës së Shën Kollit në fshatin Perondi, Kuçovë, monument kulture kategoria e parë.

DRKK - Durrës, janë kryer punime mirmbajtje e konsolidimi në muret e kalasë së Durrësit, Krujës, Elbasanit, etj. pastrimi nga vegjetacioni Amfiteatrin, në Forumin Bizantin (Rotonda). Murin e Kalasë të qytetit të Durrësit, i Termave Antike, i Bazilikës Paleokristiane në Arapaj, Durrës, i Murit të Kalasë në Porto Romano, në Banesën Aleksandër Moisiu Durrës, në Kalanë e Tiranës, në Kullen e Sahatit në Kavajë, i murit të kalasë së Elbasanit, i Bazilikës Paleokristiane Elbasan, Kalanë e Zgërdheshit, në Muzeun Etnografik Kavajë, etj.

U realizua restaurimi i Kishës së Valëshit në Elbasan, si dhe vazhdon paisja me sinjalistikë dhe tabela shpjeguese të monumenteve si dhe ndriçimi i mureve të kalasë së Durrësit në bashkëpunim me bashkinë Durrës dhe projektin IPA –Adriatic, Tur Grate 2.

DRKK Durrës vazhdon Hartimin e projekteve të restaurimit mirmbajtjes e konsolidimit për disa objekte si: Hamamit të Durrësit, Banesa Aleksander Moisiu Durrës, Kulla e Sahatit, Kavajë, Kalaja e Tiranës, Amfiteatri Romak, Muzeu Etnografik, Kavajë, etj.

DRKK - Gjirokastrë, ka kryer punime mirëmbajtjeje restauruese e konservuese në Kalanë e Gjirokastrës, Sahatit në kala, kishën e Shen Merisë së Labovës etj. DRKK në bashkëpunim me qytetarët ka kryer punime restauruese e konservuese në disa banesa dhe dyqane monumente kulture, gjithashtu vazhdojnë bashkëpunimet për restaurime me CHwB (Trashëgimi pa kufi).

DRKK - Vlorë, Mirëmbajtje dhe pastrim nga vegjetacioni i monumenteve Kisha e Marmiroit, Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Mavrovës etj.

Projekti për “Rikonstrukcionin e Kishës së Shën Spiridhonit” me vlerë 5.400.000lek. është në fazën e tenderimit.

DRKK - Korçë, aktualisht po punon për restaurimin e Kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq, Shën Marisë në Voskopojë, nderhyrje në godinën e Muzeut Arkeologjik Korçë dhe shtëpinë e Vangjush Mios. Janë kryer punime restaurimi në kishat e Voskopojës si dhe janë kryer ndërhyrje emergjente për pastrimin e vegjetacionit dhe bimësisë në Kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Bazilikën e Linit, Varret e Selces dhe disa objekte të tjera monumente kulture për të paraprirë sezonin turistik. Janë kryer punime mirmbajtje dhe konservuese në Kishën e Shën Mërisë në Ishullin e Maligradit dhe është duke hartuar projektin për ndertimin e një moli në Ishullin e Maligradit, gjithashtu vazhdojnë inspektimet dhe hartimi i projekteve për objektet në rrezik.

DRkk - Shkodër janë kryer punime mirmbajtje konservimi e restaurimi në muzeun(banesën) Oso Kuka, mureve në Kalanë Rozafa, është kryer pastrim nga vegjetacioni dhe mirmbajtje e konsolidime në Kala-të Shkoder, Lezhe, Drisht, Grazhdanit Diber, Shurdhah. Pastrim i urave monument në Lezhë, pastrim dhe mirmbajtje e urës së Mesit, si dhe punimemirmbajtje në tre shtëpive monument në zonën historike Shkodër.

Vazhdon dhe nga kjo DRKK Rilevimi dhe kontrolli i zonave Bulqizë, Mat, Mirditë , Tropojë të fortifikimeve Vig, Marshej dhe Gajtan, Rilevim të kishave në sektorin Dibër, Rilevim i zonës A dhe B, kontroll i përgjithshëm në Lezhë.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare dhe Parqet Arkeologjike vazhdojnë **përgatitjen e pasaportave të Monumenteve të Kulturës kategoria e parë dhe e dytë** për të përmbushur **një nga prioritetet** e Ministrisë së Kulturës:

- përditësimin e rregullt dhe rigoroz të listës si dhe verifikimin e statusit të monumenteve të shpallura dhe atyre të propozuar për heqje nga lista,
- përpilimin e një harte risku për të gjitha monumentet e veçanta por edhe për qendrat historike dhe parqet arkeologjike.

Një mbështetje e madhe për këtë produkt është edhe nisma e MK “Miku i Monumentit” përfshirja e shkollave në procesin e mbrojtjes dhe promovimit të monumenteve të kulturës dhe vlerave të trashëgimisë kulturore. Nisma “Miqte e Monumenteve” ka për qëllim kryesor edukimin e brezit të ri me anë të njohjes, ruajtjes, mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare (**edukimi përmes kulturës** dhe vlerave të trashëgimisë kulturore). Në këtë kuadër DRKK dhe Parqet Arkeologjike në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore në rrethe kanë ndërmarë veprimtari të ndryshme kulturore-artistike, orë mësimore për njohjen me historinë e monumenteve të kulturës si dhe është organizuar pastrimi dhe mirëmbajtja e këtyre monumenteve nga nxënësit e shkollave në vendodhje pranë apo afër monumenteve, duke bërë të mundur “Birësimin” që çdo shkollë do të ketë në përkujdes një monument të caktuar.

Kjo nismë ka për qëllim :

- 1) Monumentet mbrohen, kanë përkujdesjen, rijetëzohen dhe promovohen nëpërmjet energjisë krijuese të brezit të ri.
- 2) Fëmijët dhe të rinjtë edukohen nëpërmjet potencialit që bart trashëgimia kulturore.

• “Muze të Rikonstruktuar dhe përmirësuar në infrastrukturë”

Është në proces përmirësimi i infrastrukturës si dhe rritja e standarteve për një shërbim më të mirë ndaj publikut, dhe kushteve të veprimtarisë në këto institucione kështu:

Janë në proces rikonstruksioni dhe ngritje e disa muzeve dhe pavioneve të ndryshëm:

- Ngritja e Muzeut Kombëtar të Fotografisë Marubi, në Shkodër me donacion të FSHZH është në fazën e përfundimit të projekteve të restaurimit dhe të muzealizimit të tij. Ngritja e këtij muzeu do të sjellë jo vetëm një muze të ri të ruajtjes së kujtesës kombëtare por dhe rritje të vizitueshmërisë si në nivel lokal dhe kombëtar.
- Ngritja e Pavionit të Etnografisë në Muzeun Historik Kombëtar. Ngritja e këtij pavioni është një ndër prioritetet kryesore për tu përmbytur brenda vitit 2014 në funksion të promovimit të trashëgimisë materiale etnokulturore të popullit shqiptar, po fillon puna për vendosjen e materialeve muzeore në ekspozitat e realizuara.
- Në Muzeun Arkeologjik Durres pas përfundimit të fazës së parë të rikonstruksionit vijon procesi i muzealizimit i cili mbyllet brenda shtatorit të vitit 2014. Rihapja e këtij muzeu, risjell në vëmendje jo vetëm të komunitetit por edhe të vizitoreve vlerat që mbart trashëgimia arkeologjike e vendit. IMK po realizon restaurimin e objekteve muzeore në ekspozitat e muzeut.

Gjithashtu po punohet dhe në:

- Përmirësimin e infrastrukturës muzeale në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë, Muzeun Etnografik Krujë, Qendrën e Muzeumeve Berat, etj.
- Fuqizimi i kapaciteteve njerezore në sistemin e muzeve dhe parqeve arkeologjike.
- Krijimi i rrjetit kombëtar informatik të administrimit të trashëgimisë kulturore materiale
- Ngritja e kapaciteteve institucionale në Luftën Kundër Trafikimit të Pasurive Kulturore, etj.
- Inventarizimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si në muzete kombëtare dhe lokale. Krijimi i Databases Kombëtare të Objekteve të Trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme.
- Edukimin përmes kulturës dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, shkollave për vlerat që trashëgimia mbartin institucionet e ruajtjes së kujtesës në funksion të zhvillimit të komunitetit dhe me gjere.

• “Infrastrukturë e përmirësuar në Parqet Arkeologjike”

Parqet arkeologjike kryejnë në vazhdimësi mirëmbajtjen e teritorit si pastrim nga vegetacioni i lartë dhe i ulët, konsolidim të mureve, paisjen e ambjentëve me tabela informuese etj.

Në Parkun e Apollonisë është kryer pastrim dhe mirëmbajtje e kullës së rrumbullakët në hyrje të parkut, i sektorit Muri i Amforave, të Nimfeut, Agonotetët Odeoni, banesa me impluvium dhe shtëpi me mozaik, i gjimnazit dhe murit të Temenosit, etj.

Parku Bylis punon në vazhdimësi në konsolidimin e mureve, rrugicave, mozaikëve, etj.

Në këto parqe zhvillohen dhe shumë aktivitete të trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor.

Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale: “Plotësim i kartelave të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme”, janë në vëmendjen e tyre.

Gjatë kësaj periudhe ZAK Butrint është përfshirë në disa programe që kanë synuar mirëmbajtjen e monumenteve, kontrollin e vegetacionit, rritjen e shërbimeve turistike, sigurinë për turistët në

vizitën brenda parkut por edhe më gjerë në rrethinat dhe është bërë përgatitja e sitit për sezonin turistik:

- **pastrimin e Monumenteve**, mënjanimin e vegjetacionit në gjithë itinerarin turistik, riparimet e domosdoshme dhe punime të mirëmbajtjes në disa zona si në atë në hyrje, në zonën e teatrit, në zonën e trikonkës dhe në Kalanë Trekëndore.

- **përmirësimin e imazhit** në segmentin Ksamil Butrint, me një programim ditor të mbulimit të pastrimit të zonave të parkingut, itinerarit dhe menaxhimit të lëvizjes së mjeteve.

hapjen e mozaikeve, në saë të bashkëpunimit me IMK, përfshiu hapjen e mozaikeve, një proces që është kthyer tashmë në traditë dhe krahas mirëmbajtjes dhe eksplorimit të mozaikeve sjell edhe një mundësi të re për vizitorët.

Në Parqet Amantia –Orikum-Finiq (DRKK Vlorë)

Logjistika në parqe që lidhet me tabelat sinjalizuese dhe informuese në dy gjuhë, shqip dhe anglisht: Tabelat “Monument Kulture, Mbrohet nga Shteti” dhe Printimi i fletpalosjeve të reja për Parkun Arkeologjik Amantia-Orikum – Finiq.

Punime pastrimi, mirëmbajtje dhe restaurimi në Parku Arkeologjik Amantia-Orikum-Finiq”.

Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale: “Plotësim i kartelave të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshme”.

Parku Arkeologjik Antigone (DRKK Gjirokastrë)

Festivali i v-të - Ritet pagane në Antigone.

Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës u organizuar nga “Qendra Mediatike Antigonea” në bashkëpunim me DRKK Gjirokastrë.

“Miq të Antigonesë” u organizua nga DRKK Gjirokastrë / Sektori i Parkut Arkeologjik Antigone/ Adrianopol, Komuna Antigone dhe drejtues të shkollës 9-vjecare të fshatit ‘Asim Zeneli’. Aktiviteti synonte shpalljen e “Miqve të Antigonesë”.

Parqet Arkeologjik Shkodër Lezhë (DRKK Shkodër)

Mirëmbajtje Kalaja Rozafa (traurandricimi, mbjellja e selvijave)

Pastrimi i Kalave Shkoder

Vendosja e rojeve dhe kamerave në kala Shkoder

Projekti me bashkefinancim (BE – MK) në Parkun Arkeologjik të Apolonise Rehabilitimi i Manastirit të Shën Marisë për përdorim muzeal dhe peisazhi i sitit arkeologjik të Apollonisë” do të realizohet në dy vite 2014- 2015. Zbatimi në Park i projektit pritet në nisje gjatë tremujorit të fundit 2014.

“Aktivitete të trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor të realizuara”

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014 janë realizuar dhe në proces realizimi 24 aktivitete nga 50 të planifikuara.

Realizimi në vlerën 6,183,440 pasqyron likujdimet e pjesshme për aktivitete të realizuara nga shoqata e individë (nr 1-20) që kanë aplikuar dhe përfituar fondin përkatës të akorduar nga Ministria e Kulturës, në një proces përzgjedhjeje transparent dhe mbi bazë vlerash.

1. Festivali i peste i riteve pagane Antigone
2. Tezgjahistet e reja të Zadrimes

3. Inventarizimi Digital i Fondit Etnografik Zona para Alpe
4. Rritja e ndergjegjesimit dhe kultures muzeale ne Berat
5. Traditat e Vendit tim
6. E djeshmja në shërbim të së tashmes
7. Urat e Beratit flasin
8. Mbrojtja e dialekteve të gjuhës shqipe
9. Festivali i 11 instrumentistëve të vegjël Fushe Arrez
10. Trashëgimia kulturore, pasqyre e vlerave Korce
11. Oda Dibrane
12. Javet e arkitektures në Tiranë
13. "E ka kush e ka"
14. "Rrenjet e kacakavallit"
15. Permeti multikulturor CIOFF
16. Java e serenatës korçare
17. Rikthimi i grupit të Pilurit
18. Festivali i 6 nderkombëtar Bylis polifonia
19. Trashëgimia e usta Laver Bariut
20. Ripërteritja e traditës –panair artizanati
21. 21 maji –Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor
22. 8 Prilli Mbasdite Kulturore me fëmijë romë.
23. Miqtë e Monumenteve
24. 18 Maji, Dita Ndërkombëtare e Muzeve

Në vijimësi do të likujdohet pjesa e mbetur e fondit përkatës për secilin projekt si dhe do të zhvillohen aktivitetet e tjera të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë.

➤ **Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale**

Në përmbushje të prioriteteve të Ministrisë së Kulturës të pasqyruara dhe në planin vjetor të QKIPK, realizimet sipas zërave të kërkuara “Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale” për periudhën Janar – Qershor 2014 janë:

1. Kartela të reja në Katalogun “**ONUFRË**”.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2014 në katalogun “Onufri ” janë kataloguar 1051 kartela të reja , të plotësuar me të gjitha të dhënat përkatëse , që i përkasin kryesisht institucioneve shtetërore, Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat. **Gjithashtu janë plotësuar me të dhëna shtesë dhe foto 4500 kartela .**

2. Kartela të reja në Katalogun “**MARO KONDI**”

Në këtë katalog gjatë gjashtë-mujorit të parë 2014 janë regjistruar 1017 kartela të reja me të gjithë të dhënat përkatëse të personave private , gjithashtu janë bërë të gjitha transaksionet për objektet që kanë dalë jashtë vendit.

3. Kartela të reja në Katalogun “**SOTIRI**”

Në këtë katalog janë regjistruar gjithsej 7465 kartela me të gjithë të dhënat përkatëse dhe ka përfunduar si proces.

Në tërësi për 6 mujorin e parë 2014 në QKIPK janë regjistruar 9533 kartela të reja .

- **Institucionet shtetërore** **1051 kartela dhe 4500 foto**
- **Persona privat** **8482 kartela dhe 15000 foto**

Është mbajtur kontakt me të gjitha muzetë e rretheve për inventarizimin dhe katalogimin e objekteve që nuk janë regjistruar në QKIPK, si dhe paisja me foto cilësore të objekteve që janë të regjistruara.

Regjistrim të dhënash (pasaporta) të Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat, shtesa të viteve të fundit.

Projekti për pasurinë trashëgimi: “Foto ekspozitë, Fototeka Sotiri, Korçë” i cili ka mbaruar, u finalizua me ekspozitën në Korçë me datë 29.04.2014.

3. Programi: “ ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 6- mujori I 2014		Realizimi 6- mujori I 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	265,223	68.5%	255,547	81.1%	96.4%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	60,793	15.7%	51,794	16.4%	85.2%
12	01110	231	Kapitale	61,180	15.8%	7,779	2.5%	12.7%
			TOTALI	387,195	100	315,120	100	81.4%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 81%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 69% të totalit dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet korrente zënë rreth 16% të totalit dhe janë realizuar në masën 85%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 16% dhe janë realizuar në masën 13%
Mosrealizimi i fondeve në masën 18.6% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale dhe ato korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura					08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 6-mujori I 2014	Buxhet/Fakt 6-mujori I 2014	
A-00325	Veprimtari të realizuara në institucionet e art kultures		628,966	341,800	299,154	
B-00325	Veprimtari të realizuara me fondet e programit art kultures		189,291	38,725	9,297	
C-00325	Perfaqesimi në programe dhe evenimente nderkombetare		15,563	6,670	6,670	
Totali			833,820	387,195	315,120	

Për Programin “Arti dhe Kultura”, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën në MK, në zbatim të politikave dhe prioriteteve institucionale në këtë fushë, ka zhvilluar një mori aktiviteteve gjithëpërfshirëse në bashkërendim me institucionet qendrore të artit dhe kulturës, si dhe operatorë të tjerë të cilët zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e artit dhe kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Për më shumë detaje, shprehemi si më poshtë vijon:

Referuar produkteve A, B, C sipas Politikës së Programit 2015-2017:

(Produkti A) - Veprimtari të realizuara në institucionet e Artit dhe Kulturës:

Ambiente të rikonstruara në institucionet publike të artit & Rritja e aksesit të publikut pranë institucioneve publike të artit dhe kulturës.

1. Është në proces-vijueshmërie përmirësimi i infrastrukturës si dhe rritja e standarteve për një shërbim më të mirë ndaj publikut, dhe kushteve të veprimtarisë artistike – edukuese përmes kulturës, pranë institucioneve qendrore të Artit dhe Kulturës në vend.

2. Atelieja e Edukimit përmes Kulturës

Kanë vijuar përpjekjet dhe takimet e punës, me përfqaësues nga MK, GKA dhe grupet e interesit, qysh në muajin prill, për krijimin e ambienteve pranë Galerisë Kombëtare të Arteve, dhe vënien në jetë e realizimit të Projektit “Atelieja e Edukimit Artistik”, projekt i cili do të vihet në jetë falë bashkëfinancimit dhe bashkëpunimit me Fondacionin për Artet Pamore Shqiptare (FAVA). Projekti i Ateliesë së Edukimit Përmes Kulturës ka në fokus të tij, krijimin e një mjedisi për fëmijët nga mosha 5 - 8 vjeç me të gjitha kushtet e nevojshme konform rregullave të punës

edukuese dhe formuese përmes artit me fëmijët e kësaj moshe. Për krijimin e ambienteve të reja, kreative, edukative dhe promovuese për talentet e reja, në disiplinën e arteve pamore, përgjatë muajit Korrik 2014, do të zhvillohet Konkursi publik, *“Për realizimin e projektit të mjedisit të “Ateliesë së Edukimit përmes Kulturës”, në godinën e GKA në Tiranë”*.

3. Digitalizimi i Bibliotekës Kombëtare

Bibliotekës Kombëtare për vitin në vazhdim, në art.231 investime i është shtuar shuma prej 32.000.000 lekë nga buxheti i Ministrisë së Kulturës për realizimin, në cilësinë dhe standardet e duhura, e digjitalizimit të sistemit bibliotekar. Për të arritur këtë objektiv është proceduar me tenderimin e 2 skanerave të teknologjisë së fundit me kapacitet skanimit të përmasave A3 dhe A2, të cilat do ndihmojnë jo vetëm në përshpejtimin e digjitalizimit të materialeve, por dhe në ruajtjen e mëtejshme të tyre.

Gjithashtu ka filluar dhe procedura e tenderimit të microfilm scanner, që do mundësojë për herë të parë dixhitalizimin e formatit microfilm dhe ruajtjen e materialeve filmike për një kohë të gjatë.

❖ (Produkti B) - Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë:

“Thirrjen për projekt-propozime, në Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturorë”, si dhe “Udhëzuesin” mbi

procedurat që duhet të ndiqen, në kuadër të mbështetjes dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore, për Fazën e I-rë, viti 2014.

Në datën 15 Janar 2014, Ministria e Kulturës shpalli Thirrjen për projekt-propozime në fushat e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Kjo thirrje u mbyll në datën 14 shkurt 2014. Më datë 19 mars 2014, u mbyll procesi përfundimtar i vlerësimit të projekt-propozimeve të paraqitura. Kolegjumi, i përbërë nga nënpunës të mesëm dhe të lartë të Ministrisë së Kulturës, gjatë ushtrimit të funksioneve kolegjale **shqyrtoi 247 projekt-propozime nga të cilat përzgjedhi 68, në bazë të kriterëve** të shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime.

Kriteret për Fazën e I-rë, 2014 ishin: cilësia dhe origjinaliteti, qartësia dhe besueshmëria realizuese, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia, impakti dhe përputhshmëria me prioritetet e Ministrisë së Kulturës. **Edukimin përmes artit dhe kulturës, përkrahjen e të rinjve artistë.**

Projektet e përzgjedhura

mbështetën në mënyrë të pjesshme ose të plotë nga Ministria e Kulturës. *Procedurat që u ndoqën për fazën e I-rë, 2014, nga fillimi deri në përfundim të procedurave të vlerësimit për secilin projekt përfitues:*

Faza e I-rë, e dorëzimit të projekt propozimeve nisi më 15 Janar dhe përfundoi më 14 shkurt 2014.

Faza e II-të, shqyrtimi nga specialistët e fushës, për nga ana e plotësimit apo jo të dokumentacion për çdo projekt-propozim.

Faza III-të, Vendimi i Kolegjiumit, me nr.955/3Prot, Dt.19.03.2014, i cili u konsultua dhe me ekspertë të jashtëm sipas disiplinave përkatëse, nga ku u përzgjedhën projektet fituese.

Përzgjedhja e tyre u bazua në kriteret e shpallura referuar udhëzuesit që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime.

Faza e IV-të, Miratimi i Urdhrit të Ministres me nr. 67 Prot, dt. 20.03.2014, Për *“Finanacim dhe mbështetje me fonde publike të projekteve të fazës së parë të thirrjeve për aplikim”*.

Faza e V-të, shpallja e fituesve pranë ëeb-site të MK, www.kultura.gov.al

Faza e VI-të, lidhja e kontratave me secilin nga përfituesit.

Faza e VII-të, dhe përfundimtare, realizimi nga autorët, monitorimi dhe raportimi nga specialistët e fushës, për ato projekte të cilat brenda mesit të Muajit Korrik, 15/07/2014, kanë përfunduar realizimin e tyre sipas kalendarëve përkatës. Në fazën e parë të vitit 2014 ka patur 45 projekte të përzgjedhura në Art dhe Kulturë

❖ ***“Thirrjen për projekt-propozime, në Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturore”, si dhe “Udhëzuesin” mbi procedurat që duhet të ndiqen, në kuadër të mbështetjes dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore, për Fazën e II-të, viti 2014.***

Në datën 12 maj 2014, Ministria e Kulturës shpalli 'Thirrjen për projekt-propozime', **Faza E II-të**, në fushat e artit dhe kulturës përmes konferencës për shtyp, faqes zyrtare të ëeb-site, www.kultura.gov.al, shtypit mediatik dhe atij të shkruar.

Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën. Thirrja për Fazën e II të 2014, u mbyll në datën 30 maj 2014. Më datë 30 qershor 2014, u mbyll procesi përfundimtar i vlerësimit të projekt-propozimeve të paraqitura pranë MK. Kolegjumi, i përbërë nga nëpunës të mesëm dhe të lartë të Ministrisë së Kulturës, gjatë ushtrimit të funksioneve kolegjale shqyrtoi **109 projekt-propozime nga të cilat përzgjodhi 36, në bazë të kriterëve të shpallura** në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime, që janë: cilësia dhe origjinaliteti, qartësia dhe besueshmëria realizuese, qëndrueshmëria dhe vazhdimësia, impakti dhe përputhshmëria me prioritetet e Ministrisë së Kulturës – veçojmë këtu inovacionin, **edukimin përmes artit dhe kulturës, kreativitetin dhe përkrahjen e të rinjve – duke filluar nga potenciali i tyre krijues e deri tek punësimi i tyre.**

Procedurat që u ndoqën në të gjitha fazat e vlerësimit për Fazën e II-të 2014:

Faza e I-rë, e dorëzimit të projekt propozimeve ka nisur më 15 Qershor dhe përfundoi më 30 Qershor 2014.

Faza e II-të, Memo-Relacion nga Drejtoria e Përmbytjes:

Drejtuar- Anëtarëve të Kolegjiut,

Për dijeni- Ministres; Sekretares së Përgjithshme; Relacione të përgatitura nga specilaistët e fushës dhe përgjegjës sektori, sipas Drejtorive të Përmbytjes, duke bërë shqyrtimin rast pas rasti, nga ana e përmbytjes, përputhshmërisë me kriteret e shpallura, plotësimit apo jo të dokumentacionit, për çdo projekt-propozim të paraqitur pranë MK.

Faza III-të, Vendimi i Kolegjiut, me Nr. 2947 Prot, Dt.30.06.2014, i cili u konsultua dhe me ekspertë të jashtëm sipas disiplinave përkatëse, nga ku u përzgjodhën projektet fituese.

Përzgjedhja e tyre u bazua në në kriteret e shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime, Faza e II-të, 2014. Projektet e përzgjedhura u mbështeten në mënyrë të pjesshme ose të plotë nga Ministria e Kulturës.

Faza e IV-të, Miratimi i Urdhrit me Nr. 153 Prot, Dt.30.06.2014, për “Finanacim dhe mbështetje me fonde publike të projekteve të fazës së dytë të thirrjeve për aplikim”.

Faza e IV-të, shpallja e fituesve pranë ëeb-site të MK, www.kultura.gov.al

Faza e V-të, është në proces pune, lidhja e kontratave me secilin nga përfituesit.

Në fazën e dytë të vitit 2014 ka patur 36 projekte të përzgjedhura në Art dhe Kulturë.

Projekte të realizuara nga programi Art-Kulturë, për 6 mujorin e I, të vitit 2014:

1. Baleti Hera e Parë

Realizimi i shfaqjes, baletit, me titull “Hera e parë”, me pjesëmarrjen e balerinëve më elitare shqiptarë në skenat Botërore, si Anbeta Toromani, Kledi Kadiu, Erjon Kruja, Brigel Gjoka, Hektor Budlla, Leart Duraku, Rezart Stafa, Dorian Gori, Claudia Vehçi. Baleti “Hera e parë”, vjen si një ide e balerinëve Klejdi Kadiu dhe Anbeta Toromani, drejtuar nga koreografi Gentian Doda, pas përzgjedhjes së pjesëve artistike më të arrira të vëna në skenë nga këta balerinë, arriti të realizoi një performancë gjithëpërfshirëse, pranë T.K.O.B, më datë 5 Maj 2014.

2. Prellocaj në TKOB- La Stravaganza" dhe "Royaume Uni"

Në vijim të Marrëveshjes së bashkëpunimit kulturor, mes Shqipërisë dhe Francës, e cila nisi në muajin shkurt, me vizitën e Ministres Kumbaro dhe takimin me homologen e saj, Aurelie Filippetti, është vënë në jetë projekti “Prellocaj”. Ky projekt konsiston me vënien në skenë, pranë TKOB, të dy baleteve kontemporane, të Kompanisë Prellocaj, me titujt: Në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, Ministrinë e Kulturës dhe TKOB, në datat 9, 10, 11 Maj, u realizua vënia në skenë e këtyre 2 baleteve.

3. Realizimi i konkursit për Logon e 70-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë

Përgjatë muajit Maj 2014, bazuar në Urdhrin e Ministres Kumbaro, me Nr. 112 Prot, Dt. 14.05. 2014, për *“Realizimin dhe Miratimin e shpenzimeve të konkursit për Logon e 70-vjetorit të Çlirimit, nga Galeria Kombëtare e Arteve”*, u shpall konkursi pranë këtij Istitucioni. Pas zhvillimit dhe përmbushjes të të gjitha fazave zhvillimore dhe detyrimeve ligjore në fuqi, në përfundim të konkursit, Juria e ngritur për këtë qëllim vendosi: Të shpall fitues për logon e 70-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, imazhin grafik të Z. Mirjan Kamshi. Logoja për 70-vjetorin e Çlirimit do të shoqërojë të gjitha eventet zyrtare të institucioneve qendrore shtetërore, si pjesë identifikuese e përvjetorit.

4. Dita ndërkombëtare e muzikës, 21 qershor 2014

Përfshirja në axhëndën zyrtare të Ministrisë së Kulturës, e *Festës së Muzikës*, e cila u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Galerinë Kombëtare të Arteve, Liceun Artistik “Jordan Misja”, Akademinë “Hollyëod”, bazuar në Urdhrin e Ministres, me nr. 151 Prot, Dt. 20.06.2014, *“Për financimin e projektit, Dita ndërkombëtare e muzikës, 21 qershor 2014”, që do të zhvillohet në Tiranë”*. Ky projekt u paraqit si projekt-propozim nga “PIK Creative”, Sh.p.k, platforma që paraqiste një gamë të gjerë veprimtarish artistike në treen, ambinate publike, e cila u zhvillua përmes, krijimit të skenave të vogla, me muzikë të

përzgjedhur në zonën e ish-blokut dhe pranë Liceut Artistik, publik. Koncert nga artistë profesionistë, si Dren Abazi@Zig Zag Band, që u zhvillua po atë ditë pranë Galerisë Kombëtare të Arteve. Të tjera shfaqje artistike të shtrira në kohë dhe hapësirë si: pranë Parkut Rinia, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Rruga “Ibrahim Rugova”, Muzeu Historik Kombëtar, Parku Kombëtar-Liqeni, Rruga Ismail Qemali, etj.

5.Fondi Përkthimit Letrar

“Fondi i Përkthimit Letrar”, vjen si një nismë parësore e Ministrisë së Kulturës në dobi të vlerësimit dhe promovimit të kontributeve më përfaqësuese në lëmin e përkthimit nga gjuha e huaj në shqip. Projekti do të realizohet në shumën prej 2. 392. 500 lekësh nga zëri 604 nga *programin art - kulturë*”, nga të cilat me 2340.000 lekë do të paguhet përkthyesit për veprat letrare të shqipëruara nga gjuha e huaj dhe në shumën 52.500 lekë do të paguhet ekspertët e jashtëm. (në proces).

6.Logo për 200 vjetorin e lindjes së poetit arbëresh Jeronim de Rada (në proces)

Ministria e Kulturës ka shpallur vitin 2014 “Viti Jeronim De Rada” dhe ka ngritur një Komision Shtetëror me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr.84 datë 17.04.2014 “Për veprimtaritë artistike dhe kulturore që do të realizohen në kuadër të festimeve të 200 vjetorit të lindjes së poetit arbëresh Jeronim De Rada”. Në këtë kuadër Ministria e Kulturës ka vendosur që të ketë një logo zyrtare kushtuar 200- vjetorit të lindjes së poetit . Projekti do të trajtohet nga Galeria Kombëtare e Arteve, nëpërmjet shpalljes së një konkursi me karakter kombëtar. Kostoja financiare e logos, pas studimit të tregut nga Galeria Kombëtare (shkresë e GKA, nr 2670/1, datë 17.06.2014) do të jetë në shumën 180 000 L.

7.Harta e Kafeneve Letrare në Tiranë e në rrethe.

Projekti “ *Harta e kafeve letrare në Tiranë dhe në Rrethe*” i përgjigjet një prirjeje që është shfaqur në disa lokale të njohura të kryeqytetit për të kryer aktivitete kryesisht me natyrë letrare, duke ftuar poetë, shkrimtarë dhe botues. Projekti synon nxitjen e të rinjve nga një kalim kohe pasiv, drejt një kohe të lirë aktive e sidomos të angazhuar me kulturën e librit.

Bar kafetë të cilat plotësojnë kriteret e shpallura në ëeb-in e Ministrisë së Kulturës do të përfitojnë mediatizimin e cilësive artistike që ata plotësojnë dhe nxisin, do të fitojnë një vend në faqen zyrtare online të Ministrisë së Kulturës në kuadër të kësaj fushate nxitëse të leximit dhe klimës artistike, gjithashtu në derën hyrëse kryesore të bar-kafesë së përzgjedhur do të vendoset një logo që simbolikisht do të përfaqësojë dëshirën për lexim, për libër, kulturë.

Kostoja financiare e logos, pjesë përbërëse e projektit “ *Harta e kafeve letrare ne Tiranë dhe në rrethe*”, do të jetë në shumën prej 126 000 lekësh nga zëri 604 nga *programin art - kulturë*. (në proces).

8. 200-vjetori i lindjes së poetit dhe rilindësit të madh Jeronim De Rada

Ministria e Kulturës, me rastin e 200-vjetorit të lindjes së poetit dhe rilindësit të madh Jeronim De Rada, pati nderin ta shpallë vitin 2014 “Viti De Rada”. Në këtë kalendar janë përfshirë të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar dhe do të zhvillohen në Shqipëri me këtë rast.

9. Trajnim pranë Ministrisë së Kulturës, Marketimi Strategjik për Institucionet Kulturore

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me British Council organizuan përgjatë datave 10 -11 qershor 2014, trajnimin me temë: **Marketimi Strategjik për Institucionet Kulturore**.

10. Krijimi dhe aktivizimi i portalit www.artport.al

Në kuadër të fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, duke synuar zhvillimin e politikave mbështetëse në fushën e artit bashkëkohor, Drejtoria e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës, së shpejti konkretizon punën e nisur muaj më parë, në lidhje me krijimin e një portali që do të pasqyrojë të gjitha të dhënat e subjekteve që veprojnë në fushën e artit bashkëkohor, në një platformë dixhitale publike.

E konceptuar si një faqe ëeb-i për artin bashkëkohor, www.artport.al; portali do të gjenerojë të dhënat e kontakteve për organizatat që janë aktive në skenën e artit bashkëkohor të kryeqytetit, dhe më gjerë. www.artport.al; do të jetë në interes të individëve dhe organizatave që punojnë në fushën e artit bashkëkohor, do të ndihmojë në një vizibilitet më të lartë, jo vetëm për publikun artdashës të vendit, por edhe kërkesave të partneriteteve të mundshme institucionale, dhe private ndërkombëtar.

Kjo iniciativë është bazuar në disa eksperiencat të suksesshme ndërkombëtare, kushtuar artit bashkëkohor, si: INDEX Berlin <http://www.indexberlin.de/> dhe BERLINARTLINK www.berlinartlink.com.

Në proces pune është trajnimi i stafit, (*specialistë të Drejtorisë-përdoruesit-users*), mbi mënyrat e hyrjes, hedhjes së informacionit, pasurimin dhe përditësimin e tij në kohë reale si dhe të gjithateknikat e domosdoshme për një efikasitet të lartë në funksionimin e www.artport.al.

❖ (Produkti C) - Përfaqësimi në programe dhe evidenimente ndërkombëtare:

Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe sjellja e eksperiencave më të mira të artistëve shqiptarë që jetojnë jashtë në skenat e vendit si psh:

1. Përfaqësimi i Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës, Venecia, Itali, e cila u çel më datë 7 qershor 2014, e që do të vazhdojë deri më 23 nëntor 2014. Përfaqësimi u realizua me sukses nga 2 kuratorët e pavionit shqiptar, Znj. Jonida Turani dhe Z. Stefano R. Pansera. Pavioni i Shqipërisë në këtë Bienale, titullohet “Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuara”, dhe u prezantuan punët e dy artistëve shqiptarë “Penthouse” (Shtesat), një seri pikturash nga Edi Hila dhe “The Column” (Kolona), video/instalacioni nga Adrian Paci. Prezantimi me sukses i

Shqipërisë në këtë eveniment të rëndësishëm artistiko-kulturor, pati dhe vazhdon të ketë jehonë gjithëpërfshirëse në fushën e artit vizual botëor, përmes mas-medias, shtypit të shkruar, grupeve artistike elitare botërore, rrjeteve sociale.

2. Në kuadër të kalendarit të përbashkët Shqipëri –Kosovë, Shqipëri u prezantua me 30 (tridhjetë) skulpturave të Kompleksit skulpturorë “Satira në skulpturë”, të autorit Uran Hajdari, pjesë e Fondit të GKA, në ekspozitën ndërkombëtare “Çmimi Muslim Mulliqi 2014 Edicioni i X-të”, Prishtinë, Kosovë.

3. Pjesëmarrja e QKK, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, Karlovy Vary 2014, Çeki, me filmin BOTA. Ky film, me regji dhe skenar të Iris Elezi dhe Thomas Logoreci, pati premierën dhe suksesin botëror në festivalin prestigjioz të Karlovy Vary-t, që u zhvillua në Çeki, përgjatë datave 4 - 12 Korrik 2014. Filmi, BOTA, produksion i Era Film, është filmi i bashkëfinancuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Ministria e Kulturës Italiane, mbështetur dhe nga Euroimages. Ministria e Kulturës në mbështetje të prezantimit të filmit shqiptar, në arenën ndërkombëtare, miratoi Urdhrin, Nr. 152/1 Prot, dt. 30.06.2014, *“Për financim të përfaqësimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit “Karlovy Vary 2014”, në të cilin mbuloheshin zërat për 2 aktoret protagoniste në këtë film, si dhe për Znj. Milena Selimi, Këshilltare për Mediat pranë MK.*

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,